



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Janar, 2019

Takim i rëndësishëm në ambientet e Parlamentit të Kosovës Institucionet bënë edhe një hap tutje




Pas ofertës së parë nga Kryeministri dhe institucionet, e cila nuk ishte pranuar nga SBASHK, por kishte hyrë në listën e koeficienteve, Këshilli Qendror Grevist u ishte drejtuar institucioneve dhe deputetëve me shkresa që të reflektojnë në përmirësimin e koeficienteve për tërë sistemin arsimor se në të kundërtën grevës nuk do t'i dihej fundi. Ministri Hamza kishte pritur në një takim kryetarin e SBASHK-ut dhe menaxherin për financa dhe kishte shprehur gatishmërinë për të ndihmuar për dalje nga situata ... (faqe 8)

Dy takime në ndërtesën e Qeverisë



Nuk pati rezultate të pritura

Pas javës së parë të grevës
....(faqe 6)



Intervistë me edukatoren Florije Gashi

Florija është edukatore e vyer dhe anëtare e Këshillit Drejtues ..(faqe 3)

Ndodhi 14 janari

I tërë sistemi arsimor i Kosovës në grevë



"Greva fillon çdo ditë nga ora 9 deri në orën 12 për të gjithë grevistët e të gjitha ndërrimeve. Pas përfundimit të orarit të grevës të punësuarit lëshojnë objektin në të cilin është ... (faqe 4)

SBASHK-u nuk ishte vetëm



Përkrahje e vazhdueshme nga ETUCE dhe shumë sindikata simotra

Komiteti Evropian i Sindikatave për Arsim (ETUCE), ka ripërsëritur mbështetjen për SBASHK-un... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Një janar sfidues



Në historikun e SBASHK-ut janari i vitit 2019 do të shënohet si muaj sfidues. Pas angazhimeve të shumta që Projektligji për pagat të ndryshohej dhe sistemi arsimor të vendosej në vend meritore, Këshilli Drejtues dhe kryetarët e niveleve komunale dhe të Universiteteve duke përfillur zërin e anëtarësisë shpallën grevë të përgjithshme në tërë sistemin arsimor nga 14 janari. Greva dëshmoi unitetin e shkëlqyer të SBASHK-ut. E veçanta e kësaj greve ishte pjesëmarrja e çerdheve, të cilat u bënë shembull i mirë i unitetit dhe qëndresës.

Greva zgjati tri javë. Gjatë kësaj kohe kishte edhe takime me institucionet dhe kishte edhe lëvizje të koeficienteve. Fillimisht kjo lëvizje ishte e pamjaftueshme dhe greva vazhdonte. Duke e parë këtë unitet dhe këmbëngulësi institucionet vendosen edhe për një angazhim dhe lëvizje të koeficienteve. Kjo bëri që oferta e institucioneve dhe kërkesa e

SBASHK të jenë shumë më afër dhe u arrit marrëveshja. Pas konsultimeve të bëra me anëtarët e Këshillit Drejtues dhe me kryetarët e niveleve komunale sindikale dhe të Universiteteve u mbajt takimi i jashtëzakonshëm dhe unanimisht u mor vendimi për pezullim të grevës. Një ditë me vonë Parlamenti i Kosovës votoi Ligjin e pagave me koeficientet e ndryshuar për sistemin arsimor.

Greva tre javore lëvizi tërë opinionin dhe popullatën. Të gjithë filluan të merreshin me arsimin. Prindërit e kuptuan sa ka vlerë puna e të punësuarve në çerdhe pas vetëm për këto ditët e grevës u lodhën shumë me fëmijët apo nipat e tyre. U pa sa ka vlerë shkolla dhe mësimdhënësit. U pa se pa njerëzit e dijes nuk shkohet tutje.

Urojmë që të mos e harrojnë këtë. Urojmë që institucionet ta kenë kuptuar se SBASHK-u nuk ndalet në angazhimet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe prandaj është më mirë që me kohë dhe me dialog të plotësohen kërkesat e të punësuarve në tërë sistemin arsimor..

Ishte nder për mua të udhëheq sindikatën më të organizuar e më të përgatitur për përballje me sfidat.

Ju faleminderit.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me edukatoren Florije Gashi

Intervista me Florije Gashi, kryetare e sindikatës në çerdhen “Lulevera” Prishtinë si dhe anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut.



Florija është edukatore e vyer dhe anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut. Ajo ndjehet mirë në profesionin e saj, por pranon se nuk është e lehtë të jesh edukatore sepse punohet me filizat e këtij vendi dhe

kërkohet mund e sakrificë për të qenë çdo herë në nivel. Florija lavdëron angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Kush është Florije Gashi?

Florije Gashi është edukatore në institucionin parashkollor “Lulevera” në Prishtinë.

Punoj bashkë me kolegët e mija me zell dhe bëjmë çmos që të jemi në nivel të detyrës prej edukatoreje, detyrë kjo as pak e lehtë, por unë dhe gjithë edukatorët tjerë e duam profesionin tonë sepse punojmë me filizat e këtij vendi dhe ato meritojnë gjithë angazhimin, përkushtimin dhe dashurinë prindërore.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i edukatores sot?

Florija:

Profesioni i edukatores në ditët e sotme mund të konsiderohet si i vështirë për shkak se edukatorët sot nuk kanë autonomi edukimi të plotë tek nxënësit e tyre. Nuk është e lehtë të jesh edukatore sepse punohet me filizat e këtij vendi dhe kërkohet mund e sakrificë për të qenë çdo herë në nivel.

Profesioni i edukatores kurrë nuk ka qenë i lehtë dhe ndoshta pikërisht vështirësitë e kanë bërë teje më tërheqës.

Sot ky profesion është posaçërisht i vështirë duke

marrë parasysh kërkesat e reja që vazhdimisht imponohen dhe që janë në funksion të ngritjes së cilësisë dhe pamundësisë për t’iu përgjigjur atyre kërkesave.

Përkundër këtyre vështersive, profesioni i edukatores është shumë human, sepse ka për mision ndërtimin e një personaliteti të shëndoshë që është parakushti kryesor për një shoqëri të shëndoshë.

Prandaj ky profesion meriton një përkrahje dhe një vëmendje më serioze nga institucionet e Shtetit në mënyrë që këto vështetësi të përballohen më lehtë.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?

Florija:

Mund të them me përgjegjësi të plotë se aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut janë të shumta. Angazhimet e shumta që me dialog të zgjidhen çështjet e ngritura, besimi i anëtarësisë, uniteti i madh. Janë vetëm disa nga arritjet e SBASHK-ut.

Vlen të theksohet si një veçori dhe arritje e SBASHK-ut është se në të gjitha Institucionet Parashkollore si rezultat i punës së tyre të palodhshme kemi rritje të antarsisë.

Si një arritje tjetër konsideroj që është organizimi i trajnimeve të cilat kanë për qëllim ngritjen e cilësisë në punën tone edukativo-arsimore.

Vlen të theksohet se ne jemi të kënaqur me punën e SBASHK-ut dhe llogarisim si arritje në realizimin e kërkesave tona.

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta ?

Florija:

Duke pasur parasysh angazhimin e SBASHK-ut se gjithmonë marrin parasysh kërkesat tona, i kisha sugjeruar në trajnime që organizohen nga SBASHK të përfshihen sa më shumë mësimdhënës, edukatore.

Arsimimi sot:

Si ndiheni si anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut?

Florija:

Unë si anëtare e Këshillit Drejtues me përgjegjësinë time të plot mundohem që të përfaqësojë interesat e gjithë antarsisë në mënyrën më të dinjitetshme.

Ajo që më së shumti më bënë të ndihem e nderume si anëtare e Këshillit Drejtues është transparenca dhe këmbëngulja në realizimin e kërkesave tona si mësimdhënës – edukatore.

Arsimimi sot:

Çka te shtyri te angazhohesh si anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK-u?

Florija:

Ideja që të jem pjesë e këtij Këshilli Drejtues filloi nga ajo që zëri jonë duhet të dëgjohet në vendin e duhur dhe kjo më shtyri të pranojë këtë detyrë të re me përgjegjësinë më të madhe dhe të angazhohem

maksimalisht duke qenë çdo here zëri i antarsisë që unë e përfaqësoj.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga puna e juaj

Florija:

Sikur çdo profesion edhe profesioni i edukatores ka të veçantat e veta, që në këtë rast do ti dalloja vetëm disa prej tyre:

-Krijimi i një afërsie shumë të theksuar ndërmjet fëmijëve dhe edukatores,

-Ndikimi shumë i fortë i edukatores në formimin e personalitetit të fëmijut, po ashtu dhe ndikimi i edukatores në përgatitjen e fëmijëve për jetë.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Florija:

Shpresoj që SBASHK do ta vazhdojë angazhimin e tij në mbrojtjen e të drejtave ligjore të punëtorëve të arsimit si dhe të krijojë kushte edhe më të favorshme për ta.

Gjatë muajit

Dialogu

Kur pala tjetër nuk reflekton



Institucionet e Kosovës duhet të nxjerrin mësim nga greva 3 javore e institucioneve arsimore dhe në të ardhmen të kenë qasje meritore ndaj dialogut me sindikatat. SBASHK-u si shembulli më i mirë i angazhimit që me dialog të zgjidhen çështjet e ngritura nuk la derë pa trokitur, dërgoi shumë letra në adresat e institucioneve dhe që në fillim publikisht e

tregoi se Projektligji që po punohej ishte degradues e nënçmues dhe si i tillë edhe i papranueshëm për tërë sistemin arsimor, që nga çerdhet e deri edhe në Universitete. Sa e sa takime u mbajtën nga maji dhe ato sikur mbylleshin me përfundimin se të drejta e legjitime janë kërkesat e SBASHK-ut, por institucionet pak reflektonin. I lëviznin koeficientet në arsim duke i matur me milimetra. Institucionet është dashur të reagojnë drejt pas Protestës së 8 shtatorit, apo pas grevës njëorëshe të 28 dhjetorit në tërë sistemin arsimor, por nuk bënë diçka që do të ndryshonte situatën. SBASHK-u e tha zëshëm se greva njëorëshe e 28 dhjetorit është alarmi i fundit para grevës së përgjithshme dhe duke parë se as pas kësaj reflektimit nuk ishin të duhura u shpall greva në kohë të pacaktuar.

Ndodhi 14 Janari

I tërë sistemi arsimor i Kosovës në grevë



"Greva fillon çdo ditë nga ora 9 deri në orën 12 për të gjithë grevistët e të gjitha ndërrimeve. Pas përfundimit të orarit të grevës të punësuarit lëshojnë objektin në të cilin është zhvilluar greva për të vepruar kështu çdo ditë të grevës. Gjatë periudhës sa zgjat greva e përgjithshme ndërpriten të gjitha aktivitetet që lidhen me punën në institucionet arsimore", formuloi vendimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të kryetarëve të niveleve sindikale komunale dhe të Universiteteve, kryetari SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj.



Kjo ndodhi më 10 janar në takimim e jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues dhe të kryetarëve të niveleve sindikale komunale dhe të Universiteteve. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe Ministri i MASHT, Shyqiri Bytyqi, i cili u është drejtuar pjesëmarrësve të këtij takimi të jashtëzakonshëm me apelin që të mos shkohet në grevë të përgjithshme.

Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe kryetarët e niveleve sindikale komunale dhe të Universiteteve duke sjellë zërin e punëtorëve të arsimit nga çerdhet, arsimit fillor, arsimit mesëm i ulët, arsimit mesëm i

lartë dhe Universitetet diskutuan hapur dhe votuan njëzëri për të nisur me grevën e përgjithshme nga 14 janari.



Rrjedha e grevës që nga dita e parë është përcjellë me interesim nga mediet dhe opinioni. Këshilli Qendror Grevist ka përgatitur për rrjedhën e çdo dite të grevës raportin, të cilin ua ka dërguar të gjitha medieve të shkruara e elektronike. Do theksuar se kryetari i SBASHK-ut me anëtarë të Këshillit Qendror Grevist gjatë ditëve të grevës ka vizituar çerdhe dhe institucione të tjera arsimore për të bashkëbiseduar me grevistët nga të cilët ka marrë mbështetje të fuqishme. Këto vizita janë përcjell edhe nga mediet e nderuara, që janë dëshmuar me korrektësinë ndaj rrjedhës së grevës. Raportet ditore të grevës janë botuar edhe ne web faqen e SBASHK-ut dhe do të arkivohen për të qenë një material interesant kur shkruhet për historikun e sindikatës sonë.



Greva e përgjithshme zgjati tri javë dhe dëshmoi unitetin e sindikatës sonë. Në kudër të këtyre tri javëve të grevës SBASHK-u vazhdoi me përpjekjet që të gjendet zgjedhje edhe me dialog.

Dy takime në ndërtesën e Qeverisë Nuk pati rezultate të pritura



Pas javës së parë të grevës kryetari i SBASHK-ut ishte në një takim me Kryeministrin Haradinaj. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ministri Bytyqi dhe anëtarë të Kabinetit të Kryeministrit. Aty u fol edhe për ofertën e Qeverisë së datës 20 janar, por Këshilli Drejtues dhe kryetarët e sindikatave komunale dhe të Universiteteve këtë ofertë në takimin e jashtëzakonshëm nuk e pranuan sepse e konsideruan me të drejt si ofertë të vogël dhe se ajo nuk kishte përfshirë gjithë të punësuarit në arsim.

Një takim tjetër në përpjekje për të gjetur zgjidhje është mbajtur edhe me Zv/kryeministrin z. Fatmir Limaj, në të cilin takim prezent ishte edhe Ministri i MASHT, z. Shyqiri Bytyqi. Në këtë takim SBASHK-un e kanë përfaqësuar kryetari i SBASHK z. Rahman Jasharaj i shoqëruar nga kryetarët e sindikatave të niveleve arsimore Bardh Bardhi, Rexhep Sadiku dhe Blerim Mehmeti.

Zv/kryeministri Limaj duke dëgjuar përfaqësuesit e SBASHK-ut, të cilët e informuan edhe njëherë për kërkesat e tyre dhe për rrjedhën e grevës së përgjithshme, është shprehur se mbështet kërkesat legjitime të SBASHK-ut dhe se do të ketë angazhime të përbashkëta në këtë drejtim.



Takim tjetër i SBASHK-ut është zhvilluar me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Administratë, Qeverisje Lokale e Medie, z. Nait Hasani. Kryetari i SBASHK-ut është shoqëruar nga menaxheri për financa e administratë, z. Ymer Ymeri. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ministri i MASHT, z. Shyqiri Bytyqi dhe këshilltari i lartë i tij, z. Baton Dushi. Takimi ka zgjatuar për dy orë, por do theksuar se edhe përkundër angazhimeve të SBASHK dhe MASHT nuk pati përafrim të qëndrimeve me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Administratë.

SBASHK-u nuk ishte vetëm

Përkrahje e vazhdueshme nga ETUCE dhe shumë sindikata simotra



Komiteti Evropian i Sindikatave për Arsim (ETUCE), ka ripërsëritur mbështetjen për SBASHK-un dhe iu është drejtuar me një letër kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj dhe ministrit të MASHT-it z. Shyqeri Bytyqi në të cilën letër mes tjerash thuhet: "I nderuar Kryeministër, i nderuar ministër, Komiteti Evropian i Sindikatave për Arsim (ETUCE) përfaqëson 132 Sindikata të Arsimit dhe 11 milion punonjës të arsimit në 50 shtete të Evropës. ETUCE është një partner social në arsim në nivel të BE dhe Federatë Evropiane e Sindikatave brenda

ETUC, Konfederata e Sindikatave Evropiane. ETUCE është Rajoni Evropian i Arsimit Ndërkombëtar, federata globale e sindikatave të arsimit. Me këtë letër, ETUCE përsërit mbështetjen e saj të fuqishme për organizatën e saj anëtare në Kosovë, Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Kosovës (SBASHK). Ne mbështesim kolegët tanë në Kosovë në serinë e grevave të organizuara nga SBASHK duke filluar që nga sot, 14 janar 2019, dhe mbrojmë të drejtat e mësuesve. Së bashku me SBASHK, ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që të përmbushë dhe zbatojë premtimet e saj për rritjen e koeficientit të përdorur për llogaritjen e pagave, më konkretisht për punonjësit publikë në arsim, dhe kështu të rrisin pagat e tyre së paku 30%. Gjithashtu, ne bashkohemi në kritikën dhe shqetësimet e mëdha të SBASHK-ut për faktin se ligji si i tillë jo vetëm që i vë punonjësit publikë në arsim në një pozicion të pabarabartë dhe jo të drejtë në krahasim me punonjësit e tjerë në sektorin publik, por ligji në mënyrë eksplicite i zvogëlon ato. ETUCE së bashku me SBASHK i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që të marrë përgjegjësinë e saj dhe t'i realizoj premtimet e saj duke marrë masa konkrete”, thuhej në letrën e parë të ETUCE drejtuar institucioneve. Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës vazhdoi të përcjell nga afër situatën gjatë gjithë grevës dhe i drejtoi edhe një letër. Kësaj radhe kërkesën për angazhim konkret ETUCE ia drejtoi Kryeministrit Haradinaj, Krye parlamentarit Veseli dhe Ministrit Bytyqi.

Gjatë grevës SBASHK-ut i arritën letra, mbështetëse por edhe telefonata nga Sindikatat e Arsimit të regjionit dhe Evropë, një e tillë është ajo e Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, në të cilën letër solidarizuese thuhet se Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH) solidarizohet me kërkesat e drejta të SBASHK-ut dhe mbështet grevën pa afat që do të fillojë në datë 14.01.2019, deri në plotësimin e kërkesave nga ana e Qeverisë së Kosovës. Ne shpresojmë në impenjimin e menjëhershëm të Qeverisë, vlerësimin me seriozitetin e duhur të kërkesave të SBASHK dhe realizimin sa më parë të tyre.

Do veçuar edhe përkrahja e arritur nga Sindikata e Arsimit të Sllovenisë, mike e madhe kjo e sindikatës sonë.

Vlen të theksohet se SBASHK-ut vazhdojnë ti arrin letra mbështetëse, kësaj radhe e kemi mbështetjen e

plot nga Sindikata Kombëtare e Arsimit të Shteteve të Bashkuara (NEA) e cila ju ka drejtuar Kryeministrit Haradinaj duke i kujtuar se bashku me SBASHK-un e Kosovës janë anëtare të Edukimit Internacional i ku se bashku janë mbi 300 organizata sindikale nga me tepër se 170 shtete të botës,ku mes tjerash thuhet se "për të ofruar arsim cilësor për nxënësit, pagat e dhe kushtet për mësuarit duhet të jenë të dinjitetshme investime të cilat janë të domosdoshme." Për të shtuar se duke pasur parasysh se jeni në diskutimet të vazhdueshme me SBASHK-un, ju inkurajoj që të siguroni paga meritore për mësuesit sepse ky është në shërbim të nxënësve të Kosovës. Në fund të kësaj letrë NEA kërkon nga Kryeministri Haradinaj që të vazhdoj me bisedimet me SBASHK-un dhe sa me shpejte të arrin marrëveshjen.



Education International
Internationaler der Education
International de la Education

<http://www.ei-ie.org>

EUROPEAN REGION-
ETUCE

President
Christine BLOWER

Vice-Presidents
Odile CORDELIER
Andreas KELLER
Trudy KERPERIEN
Dorte LANGE
Galina MIERKULOVA
Brammie STRUKELJ



5, Bd du Roi Albert II, 9th
1210 Brussels, Belgium
Tel +32 2 224 06 91/92
Fax +32 2 224 06 04
secretariat@csee-etuce.org
<http://www.csee-etuce.org>

European Director
Susan Flocken

Treasurer
Mike JENNINGS

ETUCE
European Trade Union Committee for Education
EI European Region

To: Ramush Haradinaj
Prime Minister of Kosovo
E-mail: ramush.haradinaj@rks-gov.net

Shyqyri Bytyqi
Minister of Education, Science and Technology
E-mail: shyqyri.bytyqi@rks-gov.net

Brussels, 14 January 2019
Ref.: SF/vd/10029

Subject: Solidarity with the ETUCE member organisation in Kosovo²

Dear Prime Minister,
Dear Minister,

The European Trade Union Committee for Education (ETUCE) represents 132 Education Trade Unions and 11 million education personnel in 50 countries of Europe. ETUCE is a Social Partner in education at EU level and a European Trade Union Federation within ETUC, the European Trade Union Confederation. ETUCE is the European Region of Education International, the global federation of education trade unions.

With this letter, ETUCE reiterates its robust support with its member organisation in Kosovo, the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK). We stand with our colleagues in Kosovo in the series of strikes organised by SBASHK starting as of today, 14 January 2019, and advocate for teachers' rights.

Together with SBASHK, we urge the Government of Kosovo to fulfil and implement its promises to raise education employees' coefficient in the salary grid and thus increase their salaries by at least 30%.

Furthermore, we share SBASHK's strong criticism and resentment about the fact that the adopted law not only places public employees in education in an unequal and unfair position in comparison with other employees in the public sector, the law also explicitly downplays them.

ETUCE together with SBASHK calls on the Government of Kosovo to take on its responsibility and translate its promises into concrete measures.

We recall that the [Stabilisation and Association Agreement between the EU and Kosovo](#) states that [...] "The Parties shall cooperate with the aim of raising the level of general education and vocational education and training as well as youth policy and youth work in Kosovo, as means to promote skills development, employability, social inclusion and economic development in Kosovo" [...]. To this end, we further stress that decent working conditions and attractive salaries not only lay the foundation for the sustainability and prosperity of the teaching profession - bearing in mind the growing numbers of students in

² This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.

Kosovo – they are also a cornerstone of high quality education and a guarantor of a prosperous society.

ETUCE trusts that you reply to the demands made by SBASHK and fulfil your promises with a view to resolve this issue through a meaningful dialogue with an acceptable outcome for education employees in Kosovo.

ETUCE continuous monitoring situation.

Yours sincerely,

S. Flocken

Susan Flocken
European Director



To: Kadri Veseli
President of the Assembly of Kosovo
E-mail: kdr.veseli@assembly.kosovo.org

Ramush Haradinaj
Prime Minister of Kosovo
E-mail: ramush.haradinaj@rks-gov.net

Shqipri Bytyqi
Minister of Education, Science and Technology
E-mail: shqipri.bytyqi@rks-gov.net

H. Evi Kastrati, Ambassador
Embassy of the Republic of Kosovo
E-mail: ambassy.slovenia@rks-gov.net

Ljubljana, January 31st, 2019

Subject: **Solidarity with the ETUCE member organisation in Kosovo!**

Dear Prime Minister, dear President of the Assembly of Kosovo, dear Minister, dear Ambassador,

together with the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës - SBASHK) - ETUCE member organisation in Kosovo - the Education, Science and Culture Trade Union of Slovenia (Sindikata vzbege, izobrazevanja, znanosti in kulture slovenije) - SVIZ calls on you to postpone the Parliament vote on the Bill on Salaries in the public sector which is expected to be held on 31 January 2019.

We point once again to the discrimination the Bill entails against public employees in education placing them in an unequal position in comparison with other employees in the public sector.

SVIZ urges you to postpone the voting in the Parliament and to invite the education social partners to truly negotiate a rise of public education employees' coefficient in the salary grid

1 This negotiation is without prejudice to previous an status, and is in line with 2002/2004/2008 and the EU Opinion on the Kosovo education of 2010/2012.

by at least 30%, thereby positioning them in a decent standing with other public service employees.

The sustainable economic and social development of Kosovo directly depend on the quality of education. Without constructive, continuous and transparent dialogue with social partners in education and attractive and decent perspectives for teachers on the other -this development appears unlikely.

Therefore, SVIZ strongly supports our colleagues from SBASHK in their demand to:

- postpone the vote on the Bill on Salaries in the public sector, in particular in relation to the position of public service employees in education;
- negotiate a rise of public education employees' coefficient in the salary grid by at least 30%, thereby positioning them in a decent standing with other public service employees.

SVIZ calls on the Kosovar Government to engage in effective dialogue to ensure and promote attractive working conditions and quality education in Kosovo for the sustainable benefit of the country and the future generation. We are convinced that you will take the necessary measures to come to a consensus that is beneficial for the education sector and those working therein in Kosovo.

We at SVIZ, together with ETUCE, will continue to monitor the situation.

Yours sincerely,

Branimir Štrukelj,
General secretary of the Education, Science and Culture Trade Union of Slovenia

January 15, 2019

The Prime Minister Ramush Haradinaj
Republic of Kosovo

Transmitted by e-mail: ramush.haradinaj@rks-gov.net

Dear Prime Minister Ramush Haradinaj:

On behalf of the three million members of the National Education Association of the United States, I reach out to you focused on quality education and the futures of our nation. The NEA shares affiliation with the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK) in Education International, which is composed of more than 300 organizations in more than 170 nations.

In this past year, our members, public education employees, have engaged in the Red for Education movement in various states across our nation. At this moment, the movement is visible in Los Angeles, California. In delivering quality education to our students, fair salaries and good learning conditions are necessary investments. Noting the continued deliberations with SBASHK, I urge you to invest in the students of Kosovo, including the provision of appropriate resources to ensure fair salaries for teachers.

Thank you, in advance, for continuing your discussions with the leaders of SBASHK. We will await word of progress.

Sincerely,

Lily Ekelsens Garcia
President

Copies:
Minister of Education, Science and Technology, Shqipri Bytyqi, shqipri.bytyqi@rks-gov.net
Minister of Public Administration of Kosovo, Malar Topçiu, malar.topciu@rks-gov.net
President of SBASHK, Rahman Jasharaj, rahman.jasharaj@sbashk-ks.org
Vice President, SBASHK, Vjollca Shala, vjollca.shala@sbashk-ks.org
General Secretary, Education International, David Edwards, david.edwards@ei-ie.org

Takim i rëndësishëm në ambientet e Parlamentit të Kosovës Institucionet bënë edhe një hap tutje



Pas ofertës së parë nga Kryeministri dhe institucionet, e cila nuk ishte pranuar nga SBASHK, por kishte hyrë në listën e koeficienteve, Këshilli Qendror Grevist u ishte drejtuar institucioneve dhe deputetëve me shkresa që të reflektojnë në përmirësimin e koeficienteve për tërë sistemin arsimor se në të kundërtën grevës nuk do t'i dihej fundi. Ministri Hamza kishte pritur në një takim kryetarit e SBASHK-ut dhe menaxherin për financa dhe kishte shprehur gatishmërinë për të ndihmuar për dalje nga situata. Me të dalë nga ky takim stafi i SBASHK-ut komunikoi me kryetarët e niveleve komunale dhe të Universiteteve dhe pastaj edhe me anëtarët e Këshillit Drejtues duke i njoftuar për aktualitetin dhe duke kërkuar që ata të komunikojnë me kryetarë shoqatash të çerdheve, shkollave e njësive akademike për të parë se çfarë duhet bërë. Këshilli Qendror Grevist pasi kishte marrë pajtueshmërinë nga terreni pranoi të merr pjesë në takimin me krerët e shtetit.

Takimi ndodhi një ditë para se të votohej në Parlament Projektligji i pagave në ambientet e

Parlamentit të Kosovës. Në këtë takim ishin Kryeministri Ramush Haradinaj, Kryetari i Parlamentit Kadri Vesli, Ministri i Financave Bedri Hamza, Kryetari i Komisionit parlamentar për Administratë Nait Hasani dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve. Ata në takim me kryetarin e SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e administratë Ymer Ymeri ofruan ofertën e re, e cila bashkë me atë të datës 20 janar po bënte një përafrim me kërkesën e SBASHK-ut. Palët shpallen para medieve arritjen e marrëveshjes, të cilën Komisioni për Administratë e ktheu në realitet duke mbajtur takim të jashtëzakonshëm dhe duke e vënë në praktikë te koeficientet marrëveshjen e arritur. Dikush, mbase mundohet ta minimizojë, por kjo është një arritje e madhe e SBASHK-ut. Do theksuar se marrëveshja bëri që të mos ketë humbës, por të gjithë janë fitues.



SBASHK-u uron që institucionet ta kenë kuptuar se SBASHK-u është unik dhe se grevat mund të zgjasin,